

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2022

Njoftimi i kontratës për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor, i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të autoritetit kontraktor

• **Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor :**

Emri	Ministria e Mbrojtjes
Adresa	Rruga e Dibrës, (ish Shkolla e Bashkuar), Tiranë
Tel/Fax	(04) 2226601/ (04) 2226602
Kutia Postare	2423
E-mail	sekprokurime@mod.gov.al
Adresa e Internetit	www.mod.gov.al

• **Lloji i procedurës së prokurimit :** “Procedurë e kufizuar”, e klasifikuar në nivelin “Konfidencial” - (prokurim në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë).

• **Objekti i kontratës :** “Shërbim me qarqe dixhitale për nevojat e FA”.

• **Numri i referencës së procedurës :** Urdhri i prokurimit nr. 68, datë 12.09.2022.

• **Fondi limit total :** 79,164,000 (shtatëdhjetë e nëntë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) lekë pa TVSH.

• **Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin :** Duke filluar nga data e lidhjes së kontratës me përfundim brenda 3 (tre) viteve.

• **Kriteret e shpalljes së fituesit :** Çmimi më i ulët ofertës së kualifikuar.

• **Afati kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje :**

Data 25/10/2022 (brenda orarit zyrtar, nga ora 8:00 deri në orën 16.30).

Vendi i dorëzimit : Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Prokurimeve dhe Ankandeve, Kati i III, zyra nr. 205/206.

Kjo procedurë prokurimi do të zhvillohet bazuar në :

- Ligjin nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”;

- VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”;
- VKM nr. 542, datë 29.9.2021 “Për rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë” dhe përfshin dy faza kryesore:

Faza 1 - Parakualifikimi dhe përzgjedhja e kandidatëve :

Faza e parë (para kualifikimi) ka të bëjë me përzgjedhjen e kandidatëve, përpara dërgimit të ftesës për ofertë nga AK-ja. Parakualifikimi i ofertuesve është një proces i ndryshëm nga procedura e vlerësimit të ofertave, e cila përqendrohet në çmimin dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Procesi i parakualifikimit do të bëhet duke u përqendruar në vlerësimin e përvojës dhe aftësinë e kandidatëve për të zbatuar në mënyrë të kënaqshme kontratën konkrete. Qëllimi kryesor i parakualifikimit është përzgjedhja e atyre kontraktorëve/operatorëve ekonomikë, kualifikimet dhe përvoja e të cilëve minimizon rrezikun e mosekzekutimit, sipas projektit/kontratës së propozuar.

Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve në Fazën e Parë, janë përkatësisht si më poshtë :

- Operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me Certifikatën e Sigurimit Industrial (CSI), lëshuar nga DSIK, e cila duhet të jetë:
 - Jo më e ulët se niveli i klasifikimit “Konfidencial”;
 - E vlefshme në momentin e prokurimit dhe të lidhjes së kontratës së klasifikuar;
 - Në përputhje me objektin specifik të prokurimit të klasifikuar.

Për këtë, ofertuesit duhet të paraqesin Certifikatë të Sigurimit Industrial, të lëshuar nga DSIK, në emër të ofertuesit.

- Në funksion të hartimit të ofertës dhe në kushtet kur ky proces kërkon akses tek informacioni i klasifikuar që administrohet nga Autoriteti Kontraktor, operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë personelin që plotëson kushtet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar.

Për këtë, ofertuesit duhet të paraqesin :

- Dokumente/vërtetime të lëshuara nga DSIK ose CSI të lëshuar në emër të ofertuesit, ku të evidentohet personeli i pajisur me CSP si më poshtë :
- Administratori i shoqërisë
- Inxhinier TIK/Telekomunikacioni/Elektronik ose Informatikë 2 (dy)
- Teknik/Secialist të inxhinierisë elektronike dhe/ose të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit 2 (dy)

Punonjësit si më sipër, do të kenë akses në informacionin e klasifikuar lidhur me specifikimet teknike / termat e referencës, të procedurës objekt prokurimi.

Në rast se gjatë zbatimit të kontratës, operatorit ekonomik fitues do ti lindë nevoja për angazhimin e punonjësve të tjerë, ka detyrimin që aksesin në informacionin e klasifikuar të bëhet në përputhje me rregullat e përcaktuara në VKM nr. 542, datë 29.09.2021 “Për rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”.

- Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4; deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas Shtojcës 10; deklaratën mbi konfliktin e interesit, sipas shtojcës 9 dhe deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës, sipas shtojcës 11, të dokumenteve të tenderit të publikuara nga APP, në seksionin Legjislacioni/Prokurime në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, rubrika DST “Procedurë e Kufizuar Shërbime”.
- Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vetëdeklarojnë se kanë paguar të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Ky vetëdeklarim kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të lëshuar nga administrata tatimore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2019 - 2020 - 2021). Xhiro mesatare e tre viteve të fundit, nuk duhet të jetë më e ulët se 40% e vlerës së fondit limit objekt prokurimi.
- Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin kopje të bilanceve të viteve financiare 2020 dhe 2021, të paraqitura në organet tatimore dhe të çertifikuara/konfirmuara nga ana e këtyre organeve.
- Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, në një vlerë jo më të ulët se 35 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës objekt prokurimi.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik si dëshmi për përvojën e mëparshme duhet të paraqesin vërtetime të lëshuara nga një autoritet/ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*
- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

- Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të deklarojnë brezin e frekuencave që do të përdoren për transmetimin e të dhënave si dhe të paraqesin Licence për transmetim të dhënash, lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.
- Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontrates, i cili duhet të jetë pjesë e përvojës së operatorit ekonomik në fushën objekt prokurimi.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se për periudhën Korrik - Shtator 2022 kanë patur në dispozicion punonjësit si më poshtë:

a) Numri mesatar për muaj i punonjësve për periudhën në fjalë nuk duhet të jetë më i ulët se 20 (njëzet) (në këtë numër përfshihet edhe stafi drejtues).

Kjo të dëshmohet me Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën e sipërpermendur dhe të shoqërohet me list-pagesat e plotësuara rregullisht sipas formularit të përcaktuar E-SIG 025/a.

b) Në kushtet kur realizimi i kontratës përfshin mirëmbajtjen e pajisjeve të instaluar në degët e strukturave të FA-së, ku mirëmbajtja dhe suporti teknik do të jenë të garantuara 24 orë në ditë, për 7 ditë të javës, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë personelin kryesor si më poshtë:

- Të paktën 4 (katër) punonjës të diplomuar në profilin/et: Teknologji Informacioni / Inxhinier Telekomunikacioni / Elektronik ose Elektrik.

Për pjesëtarët e stafit si më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- kontratat e punës;
- diplomat universitare.

c) Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit të shoqërisë personël të pajisur me Certifikatat e kualifikimit si më poshtë:

- 2 (dy) persona të certifikuar për administrimin e pajisjeve të sigurisë në rrjete kompjuterike.

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesit duhet të paraqesë:

- kontratat e punës;
- certifikatat përkatëse të sipër cituara.

Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës 9, të këtij njoftimi, duhet të jenë në listpagesat e shoqërisë për të gjithë periudhën e kërkuar.

- Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ushtron aktivitetin tregtar sipas objektit të prokurimit, sipas normave të standardit të menaxhimit të cilësisë, sigurisë së informacionit dhe menaxhimit të shërbimeve. Për këtë duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme:

- Certifikatë ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit te cilësisë”;
- Certifikatë ISO 27001:2013 mbi “Menaxhimin e sigurisë së informacionit”;
- Certifikatë ISO 20000-1:2011 për “Menaxhimin e shërbimeve”.

Certifikatat si më sipër duhet paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomik secili operator duhet ti disponojë certifikatat e mësipërme.

Operatorët ekonomikë për tu kualifikuar në fazën e parë të procedurës, duhet të dorëzojnë dokumentacionin në përputhje me kërkesat e përcaktuara si më sipër, në një zarf të mbyllur, jo transparent, të nënshkruar dhe vulosur nga ana e tyre. Autoriteti Kontraktor, do të shqyrtojë dokumentat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e përcaktura në njoftimin e kontratës.

Formulari i kërkesës për pjesëmarrje duhet të plotësohet sipas formatit të dokumenteve të tenderit të publikuara nga APP në seksionin Legjislacioni/Prokurime në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, rubrika DST “Procedurë e Kufizuar Shërbime”.

Faza 2 - Ftesa për Ofertë dhe vlerësimi : Autoriteti Kontraktor do të dërgojë një ftesë për ofertë tek Kandidatët të cilët kanë plotësuar kërkesat për para-kualifikim duke i ftuar të njihen me dokumentet e tenderit dhe në vijim të përgatisin dhe të dorëzojnë ofertat sipas përcaktimeve në DT dhe të specifikimeve të përcaktuara në ftesën për ofertë. Ofertat do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Autoriteti Kontraktor për të përcaktuar ofertën, fituese.

Njësia e Prokurimit